

**PORTOFOL MIKS**

mundëson një balancë midis riskut dhe përfitimit

DIVERSIFIKIM I INVESTIMEVE

për fondet në monedhë të huaja

TREGJE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrje në tregjet e huaja të aksioneve/obligacioneve

Raport Mujor Shkurt 2025

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma minimale e investimit	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 3,851,164
Cmimi i kuotës	107.6246
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Numri i Investitorëve	106
Kthimi vjetor nga investimi në 28 Shkurt 2025	+7.33%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.57% per vitin 2024 ne 31.12.2024
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetëz butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet.

Obligacionet janë të investuara 29.9% në tituj borxhi dhe fonde investimi me kthim të lartë (high-yield), ku 27.1% i përket titujve të Qeverisë Shqiptare, si dhe 31.7% në obligacione dhe fonde investimi me vlerësim të lartë (investment-grade).

Pjesa e aksioneve (33.3%) është e investuar në tregje të zhvilluara: SHBA 22.5%; Zona Euro 7.3%, Britani e Madhe 1.8% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është rritur në 5.1% në fund të muajit shkurt.


Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri të lehtë negative mujore prej **-0.06%** gjatë muajit shkurt.

Yield-et e obligacioneve ranë në të gjithë SHBA-në, pasi investitorët u përqendruan drejt asetëve më pak riskoze, ndërsa tregjet europiane ofruan kthime modeste. Aksionet amerikane pësuan rënie në shkurt si rrjedhojë e të dhënave ekonomike më pak optimiste dhe shqetësimeve mbi ndikimin e mundshëm të tarifave tregtare në ekonominë amerikane. Edhe pse obligacionet dhe


aksionet europiane performuan mirë, ndikimi negativ nga aksionet amerikane mbizotëroi lehtë dhe portofoli i investimeve të fondit Raiffeisen Miks shënoi humbje të vogla gjatë muajit. Yield-i mesatar i portofolit të investimeve të fondit ishte 3.25% për një kohëzgjatje mesatare prej 2.99 vjet më 28 shkurt.

Kthimi neto vjetor i fondit është +7.33% më 28 shkurt 2025.



Ne dt 28 shkurt 2025	1 Vit	2 Vite	3 Vite	Nga lancimi (16 Dhjetor 2020)
Return in % p.a. for the period	+7.33%	+7.60%	2.97%	+1.76%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Miks per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Lulahshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat

jo te zakonshme te krijuara perkohesisht ne tregjet financiare, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Shkurt

Inflacioni i Eurozonës ra në nivelin 2.4% në shkurt, më i ulët se vlera 2.5% e janarit, por më i lartë se sa pritej nga ekonomistët e anketuar nga Reuters. Inflacioni bazë, i cili eliminon kostot e energjisë, ushqimit, alkoolit dhe duhanit, arriti në 2.6% në shkurt, gjithashtu më i ulët se rezultati i janarit.

Indeksi i çmimeve të konsumit në të gjithë ekonominë amerikane, u rrit me 0.5% për muajin janar, duke e vendosur normën vjetore të inflacionit në 3%. Norma vjetore ishte 0.1 pikë përqindjeje më e lartë se muaji dhjetor. Inflacioni bazë u rrit me 0.4% në muaj, duke e vendosur normën e inflacionit 12-mujor në 3.3%. Norma bazë vjetore gjithashtu u rrit me 0.1 pikë përqindje nga dhjetori.

Inflacioni u rrit më shumë se sa ishte parashikuar në janar, duke i dhënë një nxitje të mëtejshme Rezervës Federale për të mbajtur normat e interesit në të njëjtin nivel. Procesverbalet nga takimi i FOMC i janarit treguan se politikëbërësit duan të shohin "progres të mëtejshëm mbi inflacionin" përpara se të shqyrtojnë çdo ulje të mëtejshme të normës.

Banka Qendrore Europiane ka shumë të ngjarë të ulë përsëri normat e interesit me 25 pikë në takimin e marsit, duke ulur kështu normat për të gjashtë herë që nga qershori. Megjithatë, periudha e uljes së normave ndoshta po i afrohet fundit, ndërsa inflacioni ngadalësohet dhe ekonomia haset me ndryshime të konsiderueshme gjeopolitike.

Ngjarjet në Europë tërhoqën vëmendjen, duke përfshirë zgjedhjet gjermane, ku Kristian-Demokratët (CDU/CSU) të udhëhequr nga Friedrich Merz shpallën fitoren. Për më tepër, diskutimet e vazhdueshme mbi luftën në Ukrainë ngritën pikëpyetje në lidhje me shpenzimet e mbrojtjes në të gjithë Europën, dhe përdorimi agresiv i tarifave si kërcënim nga administrata Trump rriti gjithashtu pasigurinë në tregje.

Ndërsa investitorët u përqendruan drejt asetëve më pak riskoze, obligacionet qeveritare të SHBA-së u favorizuan, duke shkakuar rënie të yield-ëve (yield-et lëvizin në drejtim të kundërt me çmimet). Në frontin e obligacioneve të korporatave, kushtet e tregut ishin më pak të favorshme. Investitorët filluan të perceptonin nivel më të lartë risku, shkakuar ky që spread-et e obligacioneve të korporatave (diferenca në yield midis obligacioneve të korporatave dhe atyre të qeverisë) të zgjerohen. Kjo ndodhi në tregjet e obligacioneve me vlerësim të lartë, por edhe në tregjet e obligacioneve me yield të lartë. Obligacionet e thesarit të SHBA-së performuan më mirë se tregjet e tjera botërore të obligacioneve qeveritare. Tregjet europiane të obligacioneve qeveritare dhuruan kthime modeste: obligacionet 10-vjeçare gjermane me yield 2.39%, obligacionet qeveritare 10-vjeçare spanjolle 3.10% dhe obligacionet 10-vjeçare italiane 3.47%.

Aksionet amerikane pësuan rënie në shkurt si rrjedhojë e të dhënave ekonomike më pak optimiste dhe shqetësimeve mbi ndikimin e mundshëm të tarifave tregtare në ekonominë amerikane. Sektorët që performuan më dobët ishin mallarat e luksit dhe shërbimet e komunikimit. Përkundrazi, aksionet e Eurozonës avancuan në shkurt. Sektori financiar udhëhoqi kthimet e larta, me aksionet e bankave që përgjithësisht performuan mirë mes fitimeve të qëndrueshme të korporatave dhe planeve për t'u dhënë një pjesë të kthimeve aksionerëve. Brenda industrive, aksionet e sektorit të mbrojtjes lëvizën dukshëm sipas pritshmërive që qeveritë europiane do të duhet të rrisin shpenzimet ushtarake.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.